



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë –Ministarstvo Pravde –Ministry of Justice

RREGULLORE MD – Nr .05 /2025
PËR PUNËN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR VLERËSIMIN E
KANDIDATËVE PËR LICENCIM ADMINISTRATOR FALIMENTUES¹

¹ Rregullore MD – Nr .05 /2025 për punën e Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e kandidatëve për licencim Administrator Falimentues, i nënshkruar nga Ushtruesi i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë me datë: 13.10.2025, me Vendim Nr. 396 /2025, të datës 13.10.2025.

Ministri i Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 168 (paragrafi 7) të Ligjit nr. 08/L-256 për Falimentimin, në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

**RREGULLORE MD - Nr. 05/2025
PËR PUNËN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR VLERËSIMIN E KANDIDATËVE
PËR LICENCIM ADMINISTRATOR FALIMENTUES**

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohet puna e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve për licencimin e administratorëve falimentues (në tekstin e mëtejme: Komisioni Vlerësues).

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me licencimin e administratorëve falimentues.

**Neni 3
Komisioni për vlerësimin e kandidatëve**

1. Komisionin për vlerësimin e kandidatëve për administrator falimentues e emëron ministri i Drejtësisë, në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës për Falimentimin.
2. Mandati i Komisionit Vlerësues është tre (3) vjeçar.

**Neni 4
Shpallja për aplikim për licencim**

Ministria publikon konkursin për aplikim për licencim për administrator falimentues në Sistemin Elektronik të Profesioneve të Lira (në tekstin e mëtejme: SEPL) dhe në faqen zyrtare të Ministrisë, në gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin përkatës për Përdorimin e Gjuhëve.

**Neni 5
Përmbajtja e konkursit publik
për aplikim për licencim të administratorëve falimentues**

1. Aplikimi për licencim për administrator falimentues bëhet në mënyrë elektronike përmes platformës e-Kosova. Aplikimi përmban këto të dhëna:

- 1.1 periudhën brenda së cilës bëhet aplikimi;
 - 1.2. dokumentacionin e nevojshëm;
 - 1.3. njoftimin për të drejtat e kandidatëve;
 - 1.4. numrin kontaktues të telefonit.
2. Në rast të pamundësisë për aplikim në mënyrë elektronike në platformën *e-Kosova*, aplikimi mund të bëhet në mënyra tjera ashtu siç parashihet me rregullat për paraqitjen e kërkesës sipas Ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
3. Konkursi publik për aplikim për licencim sipas paragrafit 1 të këtij neni do të jetë i hapur tridhjetë (30) ditë pas datës së shpalljes.

Neni 6
Dokumentet që duhet të dorëzohen
për licencim për administrator falimentues

1. Dokumentet që duhet të dorëzohen nga aplikuesi me rastin e aplikimit për licencim janë:
 - 1.1. dëshmia që nuk ju është hequr zotësia për të vepruar;
 - 1.2. certifikata shëndetësore;
 - 1.3. certifikata e dhënies së provimit për administrator falimentues.

Neni 7
Përgjegjësitë e Komisionit
Vlerësues

1. Komisioni Vlerësues, pas vlerësimit të aplikacioneve dhe të dokumentacionit të kandidatëve, brenda pesë (5) ditësh pune përpilon raportin e vlerësimit me listën e kandidatëve të propozuar për licencim si administrator falimentues, i cili i dorëzohet ministrit të Drejtësisë.
2. Raporti i vlerësimit të aplikacioneve dhe dokumentacionit përmban, por nuk kufizohet vetëm në arsyet e refuzimit të ndonjë kandidati për emërim.
3. Raporti i vlerësimit duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues.
4. Raporti i vlerësimit për çdo kandidat krijohet nga SEPL-ja.
5. Nënshkrimi i listës me kandidatët e propozuar për licencim sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 8
Kryesuesi i Komisionit Vlerësues

1. Kryesuesi i Komisionit Vlerësues:

- 1.1.thërret dhe kryeson mbledhjet e Komisionit Vlerësues;
- 1.2.kujdeset për zbatimin e kësaj Rregulloreje;
- 1.3.kryen edhe punë të tjera në pajtim me këtë Rregullore.

Neni 9
Përgjegjësitë e anëtarëve të Komisionit Vlerësues

1. Anëtarët e Komisionit Vlerësues kanë këto përgjegjësi:

- 1.1.në mënyrë të rregullt marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit Vlerësues, përveç rasteve të arsyetuara, për të cilat janë të obliguar ta njoftojnë kryesuesin e Komisionit Vlerësues;
- 1.2.të ruajnë sekretin e informacionit për punën e tyre gjatë vlerësimit të aplikacioneve dhe të dokumenteve dhe të mos zbulojnë informacione që i përkasin procesit të vlerësimit;
- 1.3.obligohen të shmangin konfliktin e interesit në pajtim me Ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

Neni 10
Kryerja e punëve administrative dhe profesionale

Punët profesionale dhe administrative teknike për Komisionin Vlerësues i kryen Departamenti përkatës për Politikë të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika në Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Blerim Sallahu

Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë

13/10/2025